



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
 QË DOKUMENTI JE PRAVNOSNAŽNA  
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
 FERIZAJ I UROŠEVAC

NË EMËR TË POPULLIT

nr. 17/17

12.09.2017

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM DIVIZIONI PENAL,** si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtarin e

vetëm gjykues Ilir Bytyqi si dhe me zyrtaren ligjore Kadishe Shabani në lëndën penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.3 të KPK-së, sipas aktakuzës PP/II nr.1187-6/16 të datës 19.10.2016 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ismet Rrahmani, të dëmtuarës [REDAKTUAR] si dhe mbrojtësit të viktimave [REDAKTUAR] dhe të pandehurit [REDAKTUAR], pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me date 12.06.2017 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 20.06.2017 përpiloi me shkrim këtë:

#### AKT GJYKIM

**I akuzuari:** [REDAKTUAR] i lindur me dt. [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], me vendbanim në Fshatin [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR], ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në "[REDAKTUAR]" i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDAKTUAR], Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

#### ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 19.07.2016, rreth orës 20:00, në shtëpinë e tyre në Fshatin [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR] pas mosmarrëveshje të vazhdueshme me të dëmtuarën – bashkëshorten e tij [REDAKTUAR], shenjë revolte pasi babai i [REDAKTUAR] kishte shkuar te shtëpia e tyre për të biseduar për shkak të problemeve të vazhdueshme që kishte i pandehuri me [REDAKTUAR] e kishte sulmuar fizikisht pa pëlqimin e saj në atë mënyrë që e kishte godit me shuplakë në fytyrë fillimisht në shtëpi e po ashtu e kishte sulmuar në veturë gjatë rrugës për në Stacion Policor duke ia vendosur dorën në gojë.

**me të cilën kreu veprën penale sulmi nga neni 187 par. 3 të KPRK-së.**

**Andaj Gjykata në bazë të nenit të sipërcituar dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, e**

## GJYKON

- *DËNIM ME BURGË NË KOHZGJATJE PREJ 6 /gjashtë/ muaj, i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet me dënim me gjobë në lartësi prej 500 euro të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.*
- *Nëse dënimi i zëvendësuar me gjobe nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-ës, do të ekzekutohet në atë mënyrë që i pandehuri për çdo 20 Euro, do të vuaj 1 /një/ ditë burgim.*
- *E dëmtuara [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.*
- *Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.*

## Arsyetimi

### Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1187-6/16 të datës 19.10.2016, kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] për shkak të veprës sulmi nga neni 187 par. 3 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 25.04.2017 si dhe shqyrtimin gjyqësor me datë 12.06.2017, në të cilat faza i akuzuari u deklarua i pafajshëm, për veprën penale sulmi nga neni 187 par.3 të KPK-së.

### **Mbrojtja e të akuzuarit**

I akuzuari në shqyrtimin fillestar si dhe në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë sulmi nga neni 187 par.3 të KPK-së.

I njëjti ka deklaruar se nuk është e vërtete që e kam sulmuar të dëmtuarën, nuk është e vërtete se unë e kam kryer këtë veprë penale për faktin se ne kemi qene ne veture te prindit tim duke shkuar ne stacion policor për ta lajmëruar një veprë penale të kanosjes nga ana e prindit te Liridonës.

Po ashtu edhe gjatë rrugës nuk e kam sulmuar [REDAKTUAR] por vete ja kam mbyll gojën me dorë dhe ajo ka bërëtitur me zë pasi që ishte, gjatë jetës time nuk e kam malltretuar pos një herë ne parkingun e [REDAKTUAR] kem pas një keqkuptim si qift.

[REDAKTUAR] i ka prerë venat për qëllime e saja dhe unë nuk kam mundur ta dijë arsyejën si dhe e njëjta ka kërkuar ta dërgoj ke familja e saj por nuk kam mundur ta dërgoj pasi isha në punë.

### **Vlesimi i mbrojtjes të të pandehurit**

Gjykata hodhi poshtë pretendimin e tij se nuk e ka kryer veprën penale me te cilën është ngarkuar pasi qe nga provat e paraqitura ekzistojnë elementet e kryerjes se kësaj vepre penale.

Gjykata çmoj dhe vlerësoj mbrojtjen e të pandehurit [REDAKTUAR] se kinse nuk e ka sulmuar, por vetëm e ka mbyllur gojën, gjoja se nuk e ka goditur në asnjë mënyrë as ne shtëpi as në veturë, por një mbrojtje të tillë gjykata nuk e aprovoj, nga fakti se nga dëshmia e të dëmtuarit dhe raporti mjekësor u vërtetua pa mëdyshje dhe në mënyrë të sigurt se i pandehuri ka sulmuar të dëmtuarën duke e goditur me shuplak në fytyrë fillimisht në shtëpi pasaj edhe rrugës për në stacion policor duke ia mbyll gojën dhunshëm për të mos dëgjohet zëri i të dëmtuarës, e dëmtuara në prezencën e të akuzuarit në seancën kryesore ka vërtetuar për faktet relevante dhe atë kohën, datën dhe vendin e sulmit, personat prezent në vendngjarje.... si në fund arsyejen pse ka ardhur deri te sulmi, i akuzuarit nuk ishin në gjendje që me pyetje dhe nënpyetje të demantoj dëshminë të dëmtuarës dhe raportin e Qendres Emergjente të dt. 20.07.2016.

### **Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**



Pasi që i akuzuari, nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale sulmi nga neni 187 par.3 të KPK-së .Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetohet gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- Nga dëshmia e dëshmitares- te dëmtuarës [REDAKTUAR]
- Nga përmbajtja e raportit mjekësor i datës 20.07.2016;
- Pjesërisht nga mbrojtja e të pandehurit [REDAKTUAR]

#### **Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Fillimisht Gjykata vlerëson si të pakontestueshme dhe të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Sepse me datë 19.07.2016, rreth orës 20:00, në shtëpinë e tyre në Fshatin [REDAKTUAR] Komuna [REDAKTUAR], pas mosmarrëveshje të vazhdueshme me të dëmtuarën – bashkëshorten e tij [REDAKTUAR], shenjë revolte pasi babai i [REDAKTUAR] kishte shkuar te shtëpia e tyre për të biseduar për shkak të problemeve të vazhdueshme që kishte i pandehuri me [REDAKTUAR] e kishte sulmuar fizikisht pa pëlqimin e saj në atë mënyrë që e kishte godit me shuplakë në fytyrë fillimisht në shtëpi e po ashtu e kishte sulmuar në veturë gjatë rrugës për në Stacion Policor duke ia vendosur dorën në gojë.

Gjykata gjendjen faktike e vërtetoi duke u bazuar nga dëshmia e dëshmitares- te dëmtuarës [REDAKTUAR] si dhe nga raportit mjekësor i datës 20.07.2016 si dhe nga provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit**

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale të sulmit nga neni 187 par. 3 për

te pandehurin [REDACTED], të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

Nga interpretimi dispozitës te nenin 187 arrihet në përfundimin se: ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe integritetit fizik, të personit, cenimi i të cilit pas sjell përgjegjësi penale. Këto veprime, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që të kenë prekur shëndetin e personit, konkretisht funksionimin normal të trupit të të dëmtuarit, duke i sjelle atij paaftësi te përkohshme. Pos kësaj kjo vepër penale merr në mbrojtje jetën dhe trupin e njeriut. Në rastin konkret veprimet e sulmit duhet të sjellin si pasojë cenimin e integritetit fizik, psikosocial e ekonomik, rrethanë kjo cilësuese e veprës penale.

### **Fjala përfundimtare e paleve**

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë akuzës ndaj të akuzuarit, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.3 të KPK-së. Eshtë vërtetuar fakti se ditën kritike e njëjta është sulmuar nga i pandehuri [REDACTED] pasi fillimisht kishte patur disa mosmarrëveshje i pandehuri në shtëpi e tij e godet me shuplaka në pjesën e fytyrës e po ashtu në seancën gjyqësore të sodit e dëmtuara ka vërtetuar se deri sa kanë qene duke shkuar në stacion policor mbrapa në ulësen e veturës i pandehuri e kishte goditur me shuplaka. I pandehuri nuk e mohon se ditën kritike ka qene se bashku në veturë me të dëmtuarën dhe prindin e tij dhe pohuar se vetëm ia ka mbyll gojën me dorë ky i pandehuri ka për qëllim vetëm të ik përgjegjësisë penale duke patur parasysh faktin se e dëmtuara me vone ishte mjekuar andaj i propozoj gjykatës të pandehurin të shpall fajtor dhe të shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligje.

Mbrojtësi i viktimave [REDACTED] në fjalën përfundimtare ka mbështet prokurorin e shtetit dhe se gjate shqyrtimit gjyqësor me prezantimin e provave materiale, dëgjimin e të dëmtuarës është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barr, andaj kërkoj nga gjykata të pandehurin ta shpall fajtor dhe të shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligje.

I pandehuri [REDACTED] në fjalën përfundimtare propozon ta liroj nga përgjegjësia penale në mungesë të provave materiale si dhe gjate këtij shqyrtimi gjyqësor nuk është vërtetuar në asnjë mënyrë fajësia ime.

### Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-ës rrethanë lehtësuese nuk gjeti, ndërsa si rrethane renduese mospranimin e fajësisë edhe përkundër provave të qarta materiale.

Gjykata është e bindur se me anë të këtij dënimi është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPK-ës, dhe me këtë dënim që është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, rrethanat dhe mënyrën e kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit, se me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale), se përmes këtij dënimi do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

E dëmtuara [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.


Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ P.nr.995/16 dt. 20.06.2017**

Zyrtare ligjore  
Kadishe Shabani

**Gjyqtari: Ilir BYTYQI**



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimin të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.